



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

URDHËR  
Nr. 329, datë 29.12.2016

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR EMËRIMIN E  
ZËVENDËSDREJTUESIT TË PROKURORISË”**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 44 pika 6 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullave për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë, si vijon:
  - a) Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë zgjidhet nga radhët e drejtuesve të seksioneve që plotësojnë këto kriteret:
    - i. kanë të paktën pesë vjet përvojë si prokuror, nga të cilat të paktën tre vjet në të njëjtin nivel;
    - ii. janë vlerësuar “shumë mirë” në tre vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale.
  - b) Kancelari përgatit një relacion me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 1 shkronja “a” të këtij vendimi;
  - c) Drejtuesi i prokurorisë thërret Mbledhjen e Prokurorëve për të marrë mendimin e saj. Data, vendi dhe rendi i ditës u njoftohet prokurorëve të paktën tre ditë përpara zhvillimit të mbledhjes dhe shoqërohet nga relacioni përkatës;
  - ç) Mbledhja hapet nga drejtuesi i prokurorisë dhe me kërkesë të çdo prokurori mund të diskutohet mbi kandidaturat. Në përfundim të diskutimeve secili prokuror jep mendim nëpërmjet votimit të hapur për çdo kandidaturë. Kandidatura që ka marrë numrin më të madh të votave konsiderohet si i rekomanduar nga Mbledhja e Prokurorëve;
  - d) Për mbledhjen mbahet procesverbal i përmbledhur.

2. Drejtuesi i prokurorisë emëron zëvendës drejtuesin e prokurorisë, në përputhje me nenin 44 të ligjit 97/2016 dhe këtë urdhër. Mendimi i mbledhjes së prokurorëve nuk është i detyrueshëm për të.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**ADRIATIK LLALLA**

